



Datë: 28.05.2025
Numër Protokolli: 5026/2025

A.nr.862/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.862/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, duke vepruar sipas nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për Këshillim dhe Votim të datës të 28.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 862/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A.
- II.** Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi F.A (*tutje referuar ankuesi*), më datë 09.05.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 12.05.2025, nën shenjën A.nr.862/2025, kundër Vlerësimit të rezultateve në punë të datës 10.04.2025, të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.862/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit, të datës 19.02.2014, ka qenë i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Media dhe Mirëmbajtje të Ueb faqes* në MPJD. Tutje, më Vendimin Nr. 41/14, të datës 18.04.2014, të Komisionit për Grada dhe Disiplinë, ankuesit i është dhënë grada diplomatike Sekretar i Tretë, ndërsa, sipas Dekretit nr.134/2021, të datës 14.09.2021, të Presidentes të Republikës së Kosovës, ankuesi është emëruar Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik në Republikën Federale të Gjermanisë, në mbështetje të nenit 84, paragrafi 4, 10 dhe 25 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 10.04.2025, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024, më nivel të përgjithshëm të vlerësimit” *Ka nevojë për përmirësim*”, vlerësim të cilin ankuesi e kundërshton më ankesë në Këshill, dhe më pretendimet së nuk është bërë plani i punës, nuk ka pasur asnjë takim gjatë periudhës vlerësuese si dhe në fund të vlerësimit; Shton së ka dërguar plan të detajuar lidhur me punët e realizuar, mirëpo që nuk janë marr për bazë nga vlerësuesja, kështu që, sipas ankuesit vlerësimi është tendencioz dhe nuk reflekton performancën e vërtet të punëve. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vlerësimi i rezultateve në punës i kontestuar me ankesë.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen në këtë çështje juridike-administrative, Kolegji iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 3, paragrafi 1, ku parashihet së: *1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji...*, Po ashtu, Kolegji në trajtimin e ankesës mori parasysh nenin 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: *7.1. Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret*” dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor funksionarët publikë të emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, nuk kanë statusin e nëpunësit civilë dhe si të tillë janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të cekura si me lartë dhe duke marr parasysh se ankuesi me Dekretin me numë të Dekretit 134/2021 të datës 14.09.2021 të Presidentes të Republikës së Kosovës është i emëruar si ambasador dhe se objekti ankimor ka të bëjë me vlerësimin e rezultateve të punës si pasojë e ushtrimit të këtij funksioni, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi gjatë periudhës se ushtrimit të funksionit të Ambasadorit në Republikën Federale të Gjermanisë nuk e ka statusin e nëpunësit civil, ngase i njëjti konsiderohet funksionar publikë për aq kohë sa Dekreti me numër 134/2021 i datës 14.09.2021 i Presidentes të Republikës së Kosovës është në fuqi, dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë ekzistimit të kësaj gjendje statusore nuk ka kompetencë për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr. 862/2025 të datës 12.05.2025, sepse Këshilli sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit në këtë kontekst thekson faktin se në momentin që ankuesi lirohet nga detyra apo i përfundon mandati i funksionarit publikë i emëruar sipas dekretit presidencial nr.134/2021 të datës 14.09.2021, të njëjtit i linden të drejtat e parashikuara me legjislacionin e shërbimit civil, pasi që ankuesi para se të emërohej ambasador, sipas Akt Emërimit të datës 19.02.2014 kishte statusin e nëpunësit civil.

Kështu që, pas konstatimit së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.862/2025, të datës 12.05.2025, për shkak statusit aktual të funksionarit publikë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Aktgjykimin në rastin nr. KI214/21 të datës 06.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.862/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.A;
- Organit të punësimit: Ministres dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MPJD; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.